



Buletini Alb-Shkenca

ORGAN I PERMUJSHEM I BOTUAR NGA FORUMI I STUDIUESVE DHE SHKENCETAREVE SHQIPTARE ALB-SHKENCA ■ GUSHT 2004

www.alb-shkenca.org ● <http://alb-net.com/pipermail/alb-shkenca> ● e-mail buletini@alb-shkenca.org

MONUMENTET GREKE DHE ATO SHQIPTARE NE MUZEUN BRITANIK...

Dashnor Kokonozi

Kërkesa e qeverisë dhe e opinionit grek për kthimin e monumenteve të tyre në vendin ku u krijuan është shumë e vjetër. Në ditët tona ajo ka qenë më sistematike dhe më e organizuar, sidomos sa kohë që ministre e kulturës në qeverinë greke ishte Melina Merkuri. Ajo në të vërtetë u bë simboli i kësaj beteje juridike e politike.

Problemi nuk është kaq i thjeshtë sa duket dhe pretendimi i qeverisë britanike se ato monumente janë më mirë në një muze si ai i Londrës ku ato cilësohen si pasuri botërore, se sa në një muze lokal si ai i Akropolit në Athinë, është pak si i dyshimtë. Sipas të gjitha statistikave Greqia, Athina dhe Akropoli kanë një numër shumë më të madh vizitorësh se Anglia dhe muzetë e saj. Pastaj një objekt është pasuri e botës edhe kur ndodhet në fund të saj. Poashtu, shkencërisht nuk duhet harruar se vlerat e monumentit janë të deshifrueshme shumë më mirë në kontekstin kulturor ku u krijuan, sesa atje ku janë të shkëputur prej tij. Veprat e antikitetit grek kurrë nuk më kanë lënë të njejtën përshtypje kur i kam vizituar të rrethuara nga mjegulla dhe lagështia e Londrës apo kur i sheh të mbështjella nga afshi i nxehtë i rrasave të Plakës. Ndjesitë që përftohen janë krejt të ndryshme.

Por, kjo është vetëm një pamje e problemit. Pamja tjetër është se po të mos kishin qenë ata ambasadorë kureshtarë e që mërzhiteshin duke mos bërë asgjë gjatë mandatit të misionit të tyre diplomatik në Greqi a Turqi, po të mos kishin ekzistuar ata udhëtarë e grabitës të pasionur anglezë (po edhe të kombësive të tjera) njerëzimit do ti kishin humbur përgjithmonë perlat më të shkëlqyera të gjenisë së tij.

Shkurt, monumentet greke do të kishin pasur po atë fat që patën shumë monumente që ndodheshin në territorin shqiptar.

Mjafton të vërejmë se një mision arkeologjik

francez qysh nga fundi i shekullit të XIX-të u ngarkua nga Napoleoni i Tretë të studionte luftërat e Cezarit dhe Pompeut në trojet e Ilirisë, sjell shembuj të çuditshëm të dashurisë së madhe të vendasve për pasuritë e tyre kulturore. Kjo si për të varfërit ashtu edhe për të pasurit, si më të ditshëm që ishin.

Që të mos marr vlerat e pa merituar të një eruditi po ju rrëfej se jam ndodhur pothuaj rastësisht në këtë histori (e që më pas mu kthye në pasion), kur diku nga mesi i viteve '70 një studiues dhe gjurmues i shkëlqyer i monumenteve të vjedhura, miku im Hasan Ulqini, më ftonte në Bibliotekën Kombëtare, ku për orë të tëra duhej ti përktheja raportin (rreth treqind faqe) që misioni arkeologjik i dërgonte perandorit francez Napoleonit, si edhe disa materiale të tjera, të panjohura prej askujt më parë. Të gjithë të tjerët më pas kanë përfituar informacionin që ai botoi në një libër, pa e cituar kërkundi në mënyrë korrekte.

Taman nga kjo periudhë e nga këto përkthime më ka mbetur në mendje një fakt i trishtueshëm. Për ndërtimin e sarajeve të tyre në Berat, një familje e shquar e asaj krahine, që nuk më bën zemra ti zë emrin, por edhe sepse fakti duhet verifikuar ende, kishte marrë nga rrënojat e Apollonisë rreth shtatëdhjetë karroca me shtatore e skulptura të tjera të lashta, të cilat ishin përdorur për... të prodhuar gelqere.

Edhe me faktet e grumbulluara nga Hasan Ulqini u bënë abuzime të hatashme. Dikush botoi edhe një reportazh tek Koha jonë a tek një shtojcë e saj, që u nderua me disa çmime, që bënte fjalë për vjedhjen e thesarit të fshatit Vrap, një thesar i shkëlqyer prej enësh ari e argjendi, që reportazhisti jo vetëm e xhvati tërësisht tek libri i Ulqinit, por së largu jepte edhe idenë se faji i kësaj humbjeje binte mbi qeverinë e kohës. Duke qenë në atë kohë drejtor i Monumenteve të kulturës në ministri,

përgjegjësia tërthorazi binte mbi mua. Por kishte edhe një detaj pandershmërie në atë shkrim dhe atë që nuk e dinte autori i shkrimit e dija unë. Thesari i Vrapit ishte gjetur dhe grabitur qysh në vitin 1907...

Aleksandër Mexsi me telefoni për të kthyer një përgjigje, por unë nuk pranova për arsye se pak kohë më parë, pas një pune të gjatë me ndihmën e Interpolit dhe të karabinierisë italiane, mundëm të kthejmë në Shqipëri ikonostasin e famshëm të kishës së Shën Pjetrit në Vithkuq, që në periudhën e qeverisë së stabilitetit, me lejen e Preç Zogajt ishte nisur gjoja për restaurim në Itali dhe kish rënë në dorë të Mafias e ishte shitur. Kthimi i tij (detajet janë në buletin e ministrisë në vitin 1993) ishte një sukses i jashtëzakonshëm. Për këtë përgatitëm një komunikatë shtypi dhe e dërguam gjithandej, por Koha jonë nuk pranoi ta botojë.

Gjithsesi, duke u kthyer tek tema jonë, asgjë nuk tregon se do të ishte i ndryshëm nga monumentet shqiptare (për të qenë më të saktë: monumentet e gjetur në truallin shqiptar) edhe fati i monumenteve greke po qe se ato nuk do të qenë marrë e vendosur me kohë në muzetë e

Londrës, Parisit e Vjenës. Pjesën tjetër të punës do ta bënin ekspeditat turke dhe fshatarët e paditur (po të shihni me kujdes në themelet e shtëpive të vjetra të Myzeqesë edhe sot dallohen ca gurë të bardhë...).

Problemi ngrihet se me çfarë çmimi duhet ta paguajnë grekët këtë operacion shpëtimi? Me çmimin e një humbjeje të dytë? Pra kuptohet se përgjigja nuk është e thjeshtë dhe nganjëherë them me vete se derisa M. Merkuri vdiq nga kanceri, edhe anglezet janë pjesë e pezmit të saj... Ky është marazi grek. Por shpejt do të kuptoni se marazi shqiptar nuk është më i vogël, por ne e kemi lëkurën disi të pandjeshme. Kjo sepse prej kohësh është verejtur se ka edhe një numër të madh monumentesh shqiptare që kanë shpëtuar në saje të interesit anglez për kulturën.

Përgjithësisht ne vuajtjet e të tjerëve i përballojmë më me lehtësi se vuajtjet tona.

*Në tërësinë e tyre këto shënime janë botuar aty nga fundi i vitit 1997 në gazetën Reublika, në Tiranë.

Energjia e erës për vendet në zhvillim

Në kushtet aktuale ku ndodhen trojet shqiptare me një mungesë të theksuar energjie elektrike dhe një krizë të zgjatur prej vitesh, gjetja e burimeve të tjera alternative dhe të pastra mund të jetë një nga pikat e rëndësishme për zgjidhjen e këtij problemi.

Energjia eolike (e erës) ka një potencial të madh për vendet në zhvillim. Këtë thekson edhe raporti i fundit i programit mjedisor të Kombeve të Bashkuara (Unep). Ky raport thotë se 13% e territoreve të vendeve të varfër ka mundësi të mira për prodhimin e energjisë nga era. Më parë kjo kuotë mendohej se ishte vetëm 1% e për këtë kish penguar shumë ngritjen e centraleve eolike.

Harta e re, pjesë e një studimi prej 9 milionë e 300 mijë dollarësh, përfshin të dhënat e satelitoreve për intensitetin dhe drejtimin e erërave në 19 vende në zhvillim. Në të kaluarën këto të dhëna ishin marrë nga stacione meteorologjike shpesh të ndërtuar në pozicione jo të përshtatshme pranë aeroporteve apo të rrethuar nga pemë e ndërtesa të larta.

Ndër vendet e marrë në shqyrtim, Nikaragua, Mongolia dhe Vietnami patën potencialin më të lartë me 40% të territorit të tyre të përshtatshëm për turbinat e prodhimit të energjisë me anë të erës. Në Nikaragua, një studim qeveritar i vendit vlerësonte potencialin eolik në vetëm 200 megawatt ndërsa pas studimit të Unep-it ky potencial rezultoi të jetë 40 mijë megawatt d.m.th. i barazvlefshëm me 40 centrale bërthamore. Më pak premtuese ishin Bangladeshi vetëm me 0.2% të territorit të përdorshëm, Kuba dhe Gana.

Sipas ekspertëve të Kombeve të Bashkuara kjo hartë do të ndihmojë vendet në zhvillim që të reduktojnë faturën e tyre energjetike si pasojë e importit të energjisë dhe naftës nga vendet e tjera.

Në bazë të rezultateve të këtij studimi, janë zona të përshtatshme për centralet e erës të gjitha ato që prodhojnë 300 watt për metër katror me erëra me shpejtësi 6,4-7 metra në sekondë në lartësinë 50 metra nga toka.

ABC News

RENDESIA E NJE PATENTE PER BIZNESIN SHQIPTAR QE TE HYJE NE TREGUN NDERKOMBETAR

Arben Vrapi

Në vendet e lindjes ka një mungesë të theksuar të koncepteve se si një ide është mall dhe ajo mund të blihet e të shitet. Aktualisht skema ndërkombëtare e patentimit është në konsolidim e sipër me konceptimin e globalizimit. Edhe Shqipëria nuk bën përjashtim nga shumë vende të lindjes. Koncepti i patentimit njëqind vitet e fundit ka evoluar dhe në ditët tona ai është automatizuar falë teknologjisë informatike dhe internetit. Por edhe në vendet e zhvilluara jo të gjithë e kanë të qartë konceptin e të drejtës së autorit.

Ekonomia dhe patenta

Po ti hedhim një sy vendeve të ndryshme në botë do të kuptojmë që vendet e zhvilluara e kanë shumë të përparuar skemën e patentimit dhe e kundërta ndodh në vendet e pazhvilluara. Në një veprimtari biznesi patenta është gjëja më e rëndësishme që ajo të ketë dominim në treg. Dhe tregu i patentave është një treg më vehte me një vlerë prej 50 bilionë dollarësh në vitin 1990 që në vitin 1999 arriti vlerën 100 bilionë dollarë.

Patenta

Patenta mbron një ide të re. Kjo i jep shpikësit një të drejtë ekskluzive në treg në një kohë të kufizuar prej 20 vjetësh që ai të kompensojë gjithë energjitë që ka shpenzuar për idenë e re që ka sjellë. Shoqëria i jep një vend të privilegjuar shpikësit dhe i garanton mbrojtjen e idesë së tij e në këto kushte ai e zbulon shpikjen e tij në publik.

Po japim një shembull se si firma farmaceutike kroate "Pliva" ka patentën e azitromicinës që është një ndër antibiotikët më të shitur në vendet e lindje nga shitjet e të cilës në vitin 2000 ajo ka fituar 1.4 bilionë dollarë. Ky shembull tregon qartë që edhe firmat shqiptare mund të luajnë në këto terrene.

Shqipëria dhe patenta

Aktualisht kemi një zyrë patentash që bën vetëm rregjistrimin e patentave dhe të markave. Në vendet e zhvilluara zyra e patentave ndodhet në pjesën e fundit të rrjetit të

patentimit. Ka shumë universitete private që e kanë kthyer në biznes patentimin por gjithashtu edhe sipërmarrës private. Në Shqipëri këto skema nuk njihen ende. Më e zyrtë duket kjo tablo kur sheh se politika nuk ka kuptuar se sa i rëndësishëm është ky gur themeli për ekonominë shqiptare.

Ideja deri në patentë

Në jetën e përditshme njerëzit përballen me probleme të ndryshme ku edhe zgjidhjet janë nga më të ndryshmet. Imagjinata që përdoret për zgjidhjen e një problemi është edhe pjesa që mund të patentohet. Gjithçka që na rrethon në mjedisin ku jetojmë nuk ka qenë më parë. Njerëzit më parë e kanë imagjinuar një objekt e më pas kanë arritur ta realizojnë. Kur një njeri vjen në jetë ai gjen disa modele të matjes së vlerës e me kalimin e kohës ai fillon ta masë atë nëpërmjet këtij etaloni vlerash duke i shtuar pikë vehtes. Më pas edhe shoqëria e bën më të specializuar këtë seleksionim. Në këto kushte një individ është vetëvlerësuar nga vetja dhe nga shoqëria. Kjo është shkalla e parë e vlerësimit. Nëqoftëse një person ka kaluar shkallët e mësipërme me sukses ai ka premisa të vazhdojë më tej. Supozojmë se një person i tillë ka një ide në një fushë të caktuar, premisat për të qënë i sukseshëm janë më të mëdha.

Le të marrim një shëmbull në praktikë se si një ide bëhet mall (patentë). Të supozojmë që kemi një ide për një laps me dy maja. Shkojmë në internet në bazën e të dhënave Epo (European Patent Office, www.european-patent-office.org) ose Wipo (World Intellectual Property Organization, www.wipo.int) për të parë nëse ndër patentat e regjistruara ekziston lapsi me dy maja dhe nëqoftëse jo atëherë fillojmë të përgatisim dokumentat dhe pagesat e nevojshme për këto organizata. Nëqoftëse çdo gjë shkon normalisht atëherë pas nëntë muajsh vjen një përgjigje zyrtare për vlerën paraprake të aplikimit. Mbas këtij momenti nëse përgjigja paraprake është pozitive atëherë kjo ide e patentuar është tashmë e tregëtueshme.

LETRAT SHQIPE NE INTERNET: BIBLIOTEKA VIRTUALE E ALB-SHKENCES

Foti Cici

Siç e dini faqeve të shumta të forumit tonë ditët e fundit ju shtua edhe Seksioni i Albanologjisë me bibliotekën e tij virtuale, dhuratë kjo bujare nga grupi i [www.Shqiptar Ortodoks.com](http://www.shqiptarortodoks.com). Qysh në fillim projekti i albanologjisë ishte sugjerues në projektin ortodoks, me shpresë për të nxitur një institucion tjetër shqiptar, jo fetar, për ta plotësuar e çuar më tej atë. Projekti ortodoks, duke sjellë në internet Kristoforidhin, Nolin e të tjerë, edhe pse është albanologjik, ka përmasë e synim tjetër. Ai projekt do të vazhdojë, jashtë këtij forumi, nga i nënshkruari dhe bashkëpunëtorët e tij. Sidoqoftë albanologjia meriton të lërohet më gjerë nga një forum studiuesish e shkencëtarësh. Linku i mëposhtëm u transferua në faqet elektronike të Alb-Shkencës, dhe me kohë do të hiqet dhe logoja ekzistuese, për t'u zëvendësuar me logon e Alb-Shkencës. Mbas transferimit të librave, për disa muaj ky seksion do të vazhdojë të ekzistojë edhe në uebsajtin Shqiptar Ortodoks, me shënimin e duhur përcjellës, derisa njerëzit ta mësojnë dhe të fshihet përfundimisht.

<http://www.shqiptarortodoks.com/tekste/index.html#albanologji>

Mirëpresim bashkëpunim e të gjithëve për të dixhitalizuar libra të vjetër në shqipe ose në gjuhë të huaja, por që përmbajnë studime shqiptare. Mendojmë se përparësi ka gjuha shqipe, prandaj dhe duhet punuar për të sjellë në Internet të gjithë fjalorët e vjetër dy-gjuhësh, siç kemi filluar të bëjmë në seksionin ekzistues.

Një sferë emergjente është dhe ajo e shtypit të vjetër shqiptar, duke e nisur ndoshta me Albania-n e Konicës. Gazetat e vjetra shqiptare janë nëpër biblioteka dhe prandaj studentët dhe studiuesit urojmë të na ndihmojnë; t'i fotokopjojnë ato materiale ose t'i shtypin, nëse i gjejnë në mikrofilm.

Gjithë materialet që do të kalohen në skaner, duhet të jenë të botuara para vitit 1924. E vendosim këtë datë si shenjë historike e përqëndrimi në projekt, por dhe për të ruajtur raportet ndërkombëtare ligjore mbi dixhitalizimin e teksteve e "vdekjen" e autorësisë.

Sjellja e librave në Internet do të bëhet ashtu siç janë ata në rrethanën fizike, me alfabetet origjinale, pa vënë dorë asgjëkund, përveç vulës së bibliotekës, e cila do të fshihet, për të paraprirë shkëmbime e sqarime të padobishme.

Për të lehtësuar konceptimin e projektit, po japim një shembull. Nëse dikush ka dëshirë të skanerizojë një libër shqip, por që i cili është shkruar me alfabet arabisht a greqisht, kjo nuk sjell asnjë mëdyshje. Ai libër duhet bërë pa tjetër, sepse është pjesë e trashëgimisë shqiptare. Nëse jo, atëherë ku përket një libër shqip shkruar me një alfabet jo shqip? Për shembull, Fjalori i gjuhës shqipe, i Kristoforidhit, 1904, është vështirë të gjendet qoftë dhe në trajtën fizike. Studiuesit shqiptarë përdorin atë të vitit 1961, i cili u përgatit për botim nga Aleksandër Xhuvani. Ky gjuhëtar e transliteroi librin, duke i renditur zërat në alfabetin shqip, por dihet se alfabetet e të dy gjuhëve janë krejt ndryshe, pra ka ndryshuar gjithë rrjedha e librit. Xhuvani thotë se ka bërë dhe disa ndreqje, se ashtu ishte koha atëherë. Pra, botimi i 1961-it është për përdorim "publik", por ky forum duhet të ngjallë atë të 1904-ës, sepse vetëm ky mund të shërbejë për një studim të mirëfilltë të zërave. Jua sollëm këtë shembull për t'u orientuar se çfarë natyre ka ky projekt virtual i bibliotekës albanologjike.

Udhëzime praktike/teknike
për bashkëpunëtorët

Pavarësisht nga dëshirat e ndryshme që mund të ketë një grup njerëzish, duhet vendosur qysh në fillim se cilët libra kanë përparësi.

– Nëse dikush ka dëshirë të kalojë në skaner një libër, le të na thotë dhe ne do t'ia postojmë atij dokumentin e fotokopjuar.

– Mbas skanerizimit, imazhet në një Cd, do t'i marrë dikush tjetër, i cili do t'i bashkangjisë ato në një file Pdf, duke pastruar e duke kontrolluar rezolucionin që të jenë sa më të lexueshme jo vetëm në ekran, por edhe kur shtypen.

– Një libër nuk duhet të jetë më i rëndë se 15-20 Mb. Shpesh kjo është e pamundur, por ne kemi mundësi ti zvogëlojmë këto përmasa. Këtë mund ta bëjë dikush tjetër në grupin që do të krijohet, si dhe vendosjen e logos së Alb-

Shkencës në çdo libër, për të zvogëluar mundësinë e abuzimit në Web.

Një kontribut të veçantë deri tani ka dhënë zoti Jarel Deaton në Ohio, SHBA, i cili ka ndihmuar shumë me skanerizime dhe hulumtime nëpër biblioteka. Profesori albanolog Brian Joseph, i departamentit të gjuhësisë në Ohio State University, i cili ka një bibliotekë të pasur me punime e artikuj në albanologji, ka ndihmuar e do të ndihmojë edhe ai për të pasuruar këtë projekt. Pra, edhe një herë ftohen që të marrin pjesë e të kontribuojnë të gjithë ata që e ndjejnë e mund të bëjnë diçka.

Bashkëpunimi kërkohet për këto drejtime:

– Kërkim në bibliotekën e qytetit ku banoni apo studioni për materiale mbi shqipen e Shqipërinë dhe fotokopjim i dokumentit/librit;

– Dëshira për të shkuar në një bibliotekë që mund të sugjerojmë ne, për të fotokopjuar këtë apo atë material;

– Kalimin në skaner të dokumentave të ndryshëm, artikuj apo libra;

– Përpunimi i imazheve të skanerizuara në file Pdf. Bashkëpunim për të kontrolluar cilësinë e materialeve, për të ndrequr ndonjë detaj të tyre, për të zvogëluar “peshën” e tyre, për të vënë logon, e të tjera hollësira që kërkojnë më tepër mjeshtëri.

Publikohet raporti i fundit i Fao-s mbi gjendjen ushqimore

Në faqet elektronike të Fao-s (www.fao.org) mund të gjeni raportin e fundit mbi gjendjen ushqimore dhe bujqësinë. Ky raport tregon se ata që do të përfitojnë më tepër nga liberalizimi i tregëtisë së produkteve bujqësore do të jenë vendet e industrializuara sepse sektori i tyre bujqësor me politikat që janë sot në fuqi kanë shumë luhatje. “Janë konsumatorët e tregjeve aktualisht të mbrojtur e prodhuesit e vendeve që kanë më pak mbështetje të brendëshme ata që do të përfitojnë më tepër”.

Edhe vendet në zhvillim, në tërësinë e tyre, mund të kenë të mira nga një liberalizim, por raporti i kushton vëmendje edhe grupeve të caktuar që në periudhën e parë mund të dëmtohen. Midis tyre janë importuesit e prodhimeve ushqimore dhe vendet që gëzojnë një hyrje të privilegjuar në tregjet e mbrojtur të vendeve anëtarë të Organizatës për Kooperimin dhe Zhvillimin Ekonomik Ocse-s.

Duke patur parasysh se pjesa më e madhe e njerëzve të varfër dhe me probleme për sigurimin e ushqimeve bazë jeton në zonat rurale dhe për të mbijetuar varet kryekëput nga bujqësia, raporti nënvizon se rruga vendimtare për luftimin e varfërisë është rritja dhe zhvillimi i sektorit bujqësor. “Reformat e tregëtisë që stimulojnë prodhimin bujqësor shpesh sjellin një rritje të përgjithshme të pagave të krahut të punës jo të kualifikuar”.

Përpara se tregjet bujqësore kombëtare ti hapen konkurrencës ndërkombëtare, veçanërisht asaj që vjen nga konkures që gëzojnë subvencione financiare në vendet e tyre, është e domosdoshme që të realizohen infrastruktura dhe institucione tregëtare mbështetëse.

Raporti i Fao-s rekomandon strategji koherente e të pranueshme “të cilat do të kenë rezultate pozitive në favor të të varfërve dhe të rritjes e zhvillimit në tërësi” duke hequr dorë nga reformat konjunkturale “freno e shty” të gjykuara tepër të dëmshme.

Përveç të tjerash, është i nevojshëm një aksion në dy fronte duke sjellë nga njera anë investime për formimin e kapitalit njerëzor e krijimin e infrastrukturave dhe institucioneve dhe nga ana tjetër të furnizojë mekanizmat e mbrojtjes së të ardhurave për të ruajtur sektorët socialë më të dobët gjatë periudhës së tranzicionit drejt një tregëtie më të lirë.

Studimi i përvojave të kaluara tregon se reformat mund të ndihmojnë luftimin e urisë dhe të varfërisë n.q.s. konceptohen dhe realizohen në bazë të një strategjie të hapur në përkrahje të të varfërve. Del tepër qartë nevoja për të kryer, në fazat e para të liberalizimit të tregut, investime të caktuara dhe masa kompensimi tranzitore në favor të shtresave më të varfra.

FAO

PELIKANET E LIRIT DHE TECI I VLORES

Agron Alibali

Tek i afrohej Triportit nga Vlora, atë mëngjes të 29 tetorit 1848, piktori dhe udhëtari i njohur anglez Eduard Lir (Edward Lear), po përpiquej të shquante se çfarë mund të ishin “një pafundësi objekteve që dukeshin si gurë të mëdhenj të bardhë, të rreshtuar në mënyrë të përsosur, por që kishin diçka të çuditshme dhe jo lehtë të përshkrueshme në trajtën e tyre”. Krejt i pamundur për të përcaktuar se çfarë ishin në të vërtetë ata, Liri e pleqëroi që ta zbulonte misterin kur të afrohej edhe më. Habia e tij ishte e pamasë tek zbuloi se “gurët e mëdhenj” nuk ishin tjetër, veçse një numër shumë i madh pelikanësh...

Por, po të ringjallej Liri sot pas 160 vjetësh dhe të vizitonte të njëjtën zonë, në vend të pelikanëve ai do të duhej të pikturonte ngrehinën e madhe dhe hijerëndë të Tec-it të Vlorës, që padyshim përbën një ndër objektet ekonomike më të diskutueshme, për të mos thënë të papërshtatshme, që mund të jenë projektuar ndonjëherë në Shqipëri. Mbetet gjithsesi mister se si dhe pse, projektuesit dhe mbështetësit e Tec-it shmangën zgjidhjen shumë më të arsyeshme dhe të efektshme që do të parashikonte (1) ndërtimin e linjës energjitike Brindizi-Vlorë dhe (2) riaftësimin e Tec-it ekzistues të Fierit. Në vend të zbatimit të një platforme energjitike kombëtare që do të modernizonte kapacitete ekzistuese, do të nxiste metodat e kapjes së energjisë alternative diellore, do të ruante mjedisin dhe trashëgiminë historike kulturore, si dhe do të lidhte vendin me tregun energjistik të Italisë, ata zgjodhën të ngrenë një Tec të ri në Kepin e Triportit, në zemër të një prej perlave të Detit Mesdhe, Gjirit të Vlorës dhe Lagunës së Nartës.

Nuk është vështirë të parashikohet se, me ndërtimin e tij, jo vetëm pelikanët e Lirit do të mendohen mirë para se të shtegtojnë andej pari, por edhe vetë banorët e qytetit plakë – pa përmendur turistët e shumëpritur – do të përpiqen të gjejnë vende më të shëndetshme për të ngrysur jetën.

Nisma për ndërtimin e Tec-it në Vlorë, do të sjellë pa tjetër rrjedhime apo beteja juridike edhe të mprehta, po qe se injorohet mendimi dhe vullneti i publikut vlonjat dhe më gjerë. Qysh tash, me shumë të drejtë veprimtarët mjedisorë të Vlorës po i referohen Konventës së Arhusit për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen ndaj problemeve mjedisore, të cilën Shqipëria e ka ratifikuar më 27 qershor 2001. Konventa hyn

posaçërisht në veprim në rastet e ndërtimit të Tec-eve me kapacitet mbi 50 Mw. Qeveria është e detyruar që të zbatojë normat e saj, duke u dhënë edhe mundësinë ojç-ve në Vlorë për t’iu drejtuar edhe gjykatës (Neni 9 i Konventës) po të jetë nevoja. Nga ana tjetër, edhe rruga e referendumit vendor është mjaft e arsyeshme. Me të vërtetë, Neni 150 i Kushtetutës e parashikon këtë të drejtë të rëndësishme të sovranit.

Instrument tjetër juridik është edhe Konventa e Ramsarit për mbrojtjen e zonave lagunore. Me të drejtë qeveria Meksi e ratifikoi këtë konventë më 29 shkurt 1996. Deri sot, vetëm dy rajone të Shqipërisë janë përfshirë në të: Butrinti me sipërfaqe të mbrojtur prej 13.500 ha dhe Laguna e Karavastasë, me sipërfaqe 20.000 ha.

Autoritetet vendore në Vlorë duhet të fillojnë menjëherë procedurat që një zonë e tretë e mbrojtur sipas Ramsarit, të jetë edhe Laguna e Nartës, përfshirë Kepin e Triportit. Sipas faqes së internetit të Ramsarit, rreth 5% e popullsisë botërore të pelikanit të gjinisë *Pelicanus crispus* (rreth 1000 specie) jetojnë rregullisht në Karavasta. Një pjesë tjetër e konsiderueshme ndodhet edhe në Nartë e Triport, sikurse dëshmon edhe Liri dikur, e këta shpendë të rallë kanë nevojë për mbrojtje, madje të ngutshme dhe të rreptë.

Por ndofta Shqipëria duhet të ratifikojë urgjentisht Konventën evropiane për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike (e rishikuar), e quajtur shkurt edhe Konventa e Maltës e cila hyri në fuqi më 25 maj 1995, dhe e ratifikuar thuhet nga të gjitha vendet evropiane, me përjashtim të Shqipërisë, Bjellorusisë, Serbisë e Malit të Zi, Bosnje Hercegovinës e ndonjë vendi tjetër...! Konventa e Maltës mund të përdoret për mbrojtjen e pasurisë së madhe arkeologjike që ndodhet në mbarë rrethin e Vlorës dhe, për rastin konkret, në Triport. Me të vërtetë, sipas historikut të bashkisë së Vlorës, Triporti së bashku me Kalanë e Jangjeçit, ka qenë një qendër shumë e rëndësishme e bregdetit mesdhetar të Vlorës qysh në lashtësi. Limani i lashtë, prej nga mund të vijë edhe emri i sotëm i vendit, sot ndodhet ndofta i zhytur nën ujë, ndërsa një pjesë e mirë e gurëve të kalasë, u përdorën gjatë sundimit osman për ndërtime në Vlorë. U takon arkeologëve vendas që t’u japin përgjigje disa pyetje, si për shembull: A ka qenë përdorur Triporti në periudhën e mbretërisë ilire të Agronit e Teutës? A u përdor më pas ai nga

Perandoria Romake si një nga kryeurat e rrugës “Egnatia”? Çfarë ndodhi me Triportin gjatë sundimit të Gjergj Aranit Komnenit dhe gjatë periudhës së Skënderbeut? A ishte Triporti qendra kryesore e zbarkimit masiv të hebrenjve të larguar nga Spanja më 1492, një numër i konsiderueshëm i të cilëve (rreth 7000 frymë) u vendosën më pas në Vlorë?

E pra, ka shumë të ngjarë që Triporti – vendi ku pikërisht po projektohet ndërtimi i Tec-it të Vlorës – si dhe objekte të tjera të rëndësishme në qytet, përbën një pasuri arkeologjike të rëndësishme, ndofta me vlera të njëjësishme evropiane. Konventa e Maltës përmban dispozi-ta shumë të rëndësishme që rregullojnë, ndër të tjera, mbrojtjen e pasurisë arkeologjike në tërësi, në truall dhe nën ujë, si dhe të lidhur ngushtësisht me mjedisin dhe habitatin natyror; krijimin e “rezervave” arkeologjike për t’u studiuar nga brezat e ardhshëm; ndalimin e gërmimeve të paligjshme dhe detyrimin e raportimit të gjetjeve rastësore; minimizimin e metodës së gërmimeve (*excavation*) dhe ruajtjen apo mbulimin e materialit të zbuluar etj. Ratifikimi si dhe zbatimi i dispozitave të rëndësishme të saj, do t’u jepte fund edhe disa sjelljeve e veprimeve arrogante dhe jo-profesionale të ndonjë individi të Fondacionit “Butrinti”, që hiqen sikur Butrinti të ishte prona e babait.

Traktati Evropian i energjisë me Evropën Juglindore, është një tjetër instrument me interes, i cili shtrin efektet e legjislacionit të Bashkimit Evropian për energjetikën edhe në vendet e Evropës Juglindore. Gjithsesi, është ironike që ky traktat nuk ka asnjë ndikim në krizën e parë të rëndë energjetike të një vendi pjesëtar. Traktati, nga ana tjetër ka patur edhe kritika të ndryshme. Një ndër to lidhet me strategjinë e ndjekur për zhvillimin e energjetikës në rajon, që duket sikur krijon pozitë mbizotëruese në treg për një shtet anëtar të BE-së, në kundërshtim me interesat sovraane të shteteve të tjera, si dhe me vetë parimet themelore të BE-së. Një tjetër vërejtje ka të bëjë me trysninë e jashtëzakonshme kah privatizimi i enteve shtetërore prodhuese, ç’ka i ka shtyrë kritikët të kërkojnë vendosjen e njëfarë moratoriumi në privatizimin e kompanive shtetërore të energjitikës të vendeve të Evropës Juglindore për një periudhë të pacaktuar. Gjithashtu, ka edhe disa lëvizje energjetike rajonale që për habi të të gjithëve, anashkalojnë Shqipërinë. E tillë është linja energjetike dhe gazsjellësi Itali-Greqi, të përmendur më sipër, edhe pse Kanali i Otrantos përbën distancën gjeografike më të afërt midis gadishullit Apenin dhe atij Ballkanik.

Nuk duam të besojmë se ngritja e Tec-it në Triport u shërben më shumë interesave tregtare të huaja, të prodhueseve të pajisjeve energjetike dhe transportuesve të naftës dhe gazit, se sa atyre të publikut shqiptar. Në këtë drejtim, edhe angazhimi i konsorciumit të bankave ndërkombëtare në këtë projekt duhet parë me rezervë. Vetëm para disa muajsh, për shembull, Banka Botërore miratoi një projekt për “pastrimin” e bregdetit shqiptar. A nuk shkon ky projekt ndesh me projektin tjetër të ndërtimit të Tec-it në Vlorë? Me fjalë të tjera, Banka Botërore me njëren dorë prish atë ç’ka sapo ka rregulluar me dorën tjetër...

Por çuditë nuk mbarojnë këtu. Në shkurt të vitit 2002, pas një studimi të përbashkët shqiptaro-amerikan, u arrit në përfundimin se projekti më efektiv dhe më i dobishëm për rritjen e kapaciteteve prodhuese energjetike në vend, do të ishte riaftësimi i Tec-it ekzistues të Fierit. Ky përfundim iu paraqit menjëherë Bankës Botërore si dhe bankave të tjera pjesëmarrëse në konsorcium. Se si, qysh dhe pse u sabotua Fieri në favor të shkatërrimit të Vlorës, kjo përbën një mister.

Së fundi, sasia prej 120 milionë dollarësh që do të hidhen në Tec-in e Vlorës, nuk janë as para të dhëna falas dhe as investime të të huajve që marrin përsipër rrezikun e ardhjes në Shqipëri, dhe pra kinse u dashkan trajtuar me përparësira e lehtësira. Jo! 120 milionë dollarët janë para të shqiptarëve që konsorciumi i bankave po shtrëngon qeverinë shqiptare t’i marrë si hua me garanci sovraane, që do t’i shtohen edhe më tej sasisë së lartë të borxhit të Shqipërisë ndaj institucioneve të huaja dhe që do të duhet të paguhet në një të ardhme nga brezi i tanishëm apo i mëpasëm i shtetasve të këtij vendi. Të kuptohemi, kurrëkush nuk është kundër marrjes së huave që ndihmojnë drejtpërdrejtë zhvillimin e vendit dhe interesat e prodhuesve e konsumatorëve vendas.

Projektimi dhe ndërtimi i Tec-it të Vlorës në një prej rajoneve më të rëndësishme të vendit dhe të Mesdheut – për vlerat e rëndësishme historike, arkeologjike, mjedisore, ekologjike, turistike etj., – i vendosur me sa duket nën trysninë e pandershme të grupeve të ndryshme të interesave, me qëllim kryesisht apo vetëm fitimin maksimal në kurriz të interesave të mirëfillta zhvillimore të Vlorës dhe Shqipërisë, përbën një precedent të palejueshëm. Si i tillë, ai nuk duhet të miratohet nga shteti shqiptar. Përndryshe, ngritja e Tec-it në zemër të njërit prej gireve më të bukura dhe të rëndësishme në Mesdhe, do të ishte njëlloj sikur të ndërtohej një shkritore në Butrint, të cilën kurrëkush nuk do ta pranonte.

ÇAMERIA - SILEZIA SHQIPTARE

Dritan Halili

Duke lexuar *Buletin Alb-Shkenca* të tetorit ndesha tek artikulli i gazetarit Enver Robelli në toponimin "Shlezi" për një krahinë në Poloninë Jugperëndimore. Natyrisht, për një shqiptar jogjermanofolës ky emërtim është i pakuptimtë, prandaj, pa dashur të korrigjoj njeri, do të dëshiroja të saktësoja se krahina në fjalë përmendet në tekstet e *Historisë së Kohës së Re* në gjimnazet e Shqipërisë me emrin "Silezi". Në gjermanisht ky toponim njihet si "Schlesien" (lexo Shlezien), ndërsa në polonisht si "Śląsk" (lexo Shlonsk). Silezia ndahet nga ana gjeografike në Silezinë e Poshtme (Niederschlesien/Dolno Śląsk) dhe Silezinë e Sipërme (Oberschlesien/Górny Śląsk), një pjesë e së cilës u përfshi pas Luftës së II-të Botërore në Çekosllovakia, tashmë Çeki. Silezia banohej deri në vitin 1921 nga një popullsi gjermanofolëse dhe një popullsi që fliste dialektin silezian – një përzierje midis gjermanishtes, polonishtes dhe çekishtes, pa dyshim rrjedhojë e pushtimeve të huaja – dhe ishte e ndarë midis Gjermanisë, Polonisë dhe Çekisë. Pas Luftës së II-të Botërore popullsia gjermane u dëbua me forcë nga Ushtria e Kuqe dhe shteti polak. Për shkak të zhvendosjes së kufijve të Bashkimit Sovjetik në kurriz të Polonisë dhe kjo e fundit në kurriz të Gjermanisë, Silezia u integrua në pjesën dërmuese në Republikën Popullore të Polonisë. Polakët e

dëbuar nga Polonia Lindore, e cila tashmë ndodhet në Ukrainë, u shpërngulen për në Silezi, kështu që raporti demografik midis popullsisë gjermanofolëse, të cilës iu mohuan gjuha amtare dhe të drejtat kulturore, ndryshoi në mënyrë drastike. Dëbimi i gjermanëve nga Silezia apo nga Bohemia (Çeki) u bë me motivin e bashkëpunimit me Rajhun e III-të.

Qoftë qeveria polake, qoftë ajo çeke, edhe pse nuk ua kthyen pronat ish-silezianëve dhe sude tëve të dëbuar, kërkuan falje për dëbimin me forcë të këtyre etnive nga atdheu i tyre shekullor. Dekretet e Beneshit, të nxjerra pas luftës për dëbimin dhe konfiskimin e popullsisë gjermane nuk u hoqën, megjithatë reliket e vjetra, si ligjet e luftës midis Gjermanisë, Çekisë dhe Polonisë jo vetëm janë pezulluar e shfuqizuar, por gjenden vetëm në librat e historisë. Banorët e këtyre vendeve qarkullojnë lirshëm, pa viza, pa frikë se kanë atë apo këtë origjinë, fe, e se quhen kështu apo ashtu.

Këto sqarime i bëj më shumë për t'ju tërhequr vëmendjen se sa e ngjashme është historia e silezianëve dhe sude tëve me historinë e çamëve. Megjithë vlerat e përbashkëta, vendet e BE-së bëjnë një trajtim krejtësisht të ndryshëm të etnive. Pyetja shtrohet: Kur do të shndërrohet Demokracia Helenike në një demokraci evropiane?

Autizmi: u individualizuan zonat cerebrale jo aktive

Disa zona cerebrale kyçe duket se janë inaktive në disa persona të prekur nga autizmi. Këtë thotë një artikull i publikuar këto ditë në revistën *Nature Neuroscience* nga një grup studiuesish në Universitetin e Kalifornisë në Los Angeles, UCLA, të koordinuar nga Mirella Dapretto.

Neuronet që përfshihen drejtpërdrejt në këtë fenomen janë ata të ashtuquajtur "pasqyrë" që aktivizohen kur një njeri çon deri në fund një veprim e sheh të njejtin veprim të kryer nga një person tjetër. Bëhet fjalë për një mekanizëm bazë që na lejon të kuptojmë emocionet dhe mendimet e personave që bashkëveprojnë me ne.

Kërkimet përfshinë dhjetë fëmijë të prekur nga autizmi të cilët u studiuuan me anë të rezonancës manjetike funksionale. Krahasimi me dhjetë fëmijë të tjerë normalë nxorri në pah zonat cerebrale inaktive.

"Është hera e parë që ne kemi një provë konkrete të një shkakut të autizmit i cili merr parasysh të gjitha simptomat që lidhen me këtë sëmundje", përfundon Mirella Dapretto.

Nature Neuroscience

TE REJAT E FUNDIT NGA ALB-SHKENCA

Të nderuar anëtarë dhe ndjekës të Alb-Shkencës,

Ju njoftojmë se këto ditë përfunduar përshtatjen e versionit më të ri të sistemit të portalit të Alb-Shkencës në adresën www.alb-shkenca.org. Neim Rustemi (*neim.rustemi@alb-shkenca.org*) që është administratori teknik i portalit tonë ka kryer pa dyshim një punë të lavdërueshme në këtë drejtim.

Ju ftojmë të gjithëve të vizitoni këto faqe e të na thoni mendimet tuaja për to. Në qoftë se duke shfletuar faqet elektronike hasni në terma apo fjali që nuk ju tingëllojnë mirë ju lutemi të na informoni që t'i përshtasim ato më mirë. Gjithashtu mirëpresim çdo sugjerim apo ndihmë tjetër konkrete në mënyrë që ta përmirësojmë edhe më tej portalin e Alb-Shkencës.

Deri tani në regjistrin tonë janë shënuar 550 antarë dhe numri i vizitave në pak muajie ka kaluar numrin 25.000!

Ndër të tjera në portalin Alb-Shkenca.org është vendosur versioni më i ri i miniforumeve të Seksioneve të Alb-Shkencës. Pasi të hyni në portal, në këto miniforume ju mund të dërgoni pyetje/komente/diskutime që i përkasin degës shkencore tek seksioni përkatës. Miniforumeve e seksioneve do të shërbejnë si pika takimi dhe shkëmbimi përvoja midis studiuesve të së njejtës disiplinë shkencore.

Ka shumë rëndësi fakti që të plotësoni sa më parë profilet tuaja në duke vendosur në këtë profil edhe degën apo degët e interesit tuaj shkencor. Kjo është pikë kyçe sepse softueri i portalit shfrytëzon pikërisht këtë informacion për të grupuar anëtarët e regjistruar sipas degëve shkencore përkatëse. Tek profili i secilit anëtar të regjistruar është shtuar gjithashtu edhe një pjesë e formularit që i përket sistemit të seksioneve dhe që rea-

lizon lidhjen midis profilit të anëtarit dhe sistemit të Seksioneve të Alb-Shkencës. Ne po punojmë që lista e anëtarëve të secilit seksion të afishohet në lidhjen Seksionet e Alb-Shkencës.

Më tej, në portal do të krijojmë një lidhje të veçantë ku do të botojmë të gjitha punimet/artikujt shkencorë që janë shpërndarë deri tani në listën e forumit tonë. Ideja është që të fillojmë botimin on-line të një organi të referuar të quajtur *Analet e Alb-Shkencës*. Të gjithë jeni të ftuar të na dërgoni punimet tuaja shkencore apo përmbledhje të tyre të cilat ne do t'i konsiderojmë për botim në këtë organ.

Grupi administrues i Alb-Shkencës pas një pune të gjatë përfundoi përgatitjen e Statutit të Institutit "Alb-Shkenca" dhe biznes planit të tij të cilët janë afishuar në faqen kryesore të portalit ku mund ti lexoni, shtypni e ti shpërndani atyre që janë të interesuar.

Paraprakisht Lindita Komani, njera nga anëtarët e palodhura të Grupit administrues dërgoi një shkrim të detajuar mbi qeverisjen e Alb-Shkencës dhe perspektivën e saj. E ja tani, para jush keni Satutin e përfunduar dhe një biznes plan bazë për të cilët ju ftojmë të gjithëve që të merrni pjesë konkretisht jo vetëm në diskutime por edhe në çdo drejtim të projektit shumëdimensional të Alb-Shkencës. Ne vërtet kemi nevojë për ndihmën tuaj në çdo drejtim.

Punë të mbarë të gjithëve!

Moderatori
dhe Grupi administrues i Alb-Shkencës

BOTOHET PER HERE TE PARE NE LONDER KËRKIME NE ILIRI

nga Elsa Demo

Dorëshkrimet e viteve 1881-83 mbi kërkimet ilirike të Sir Arthur Evansit, arkeologut anglez, shohin dritën e botimit në Londër. Shtëpia botuese "Taurus" ka marrë përsipër këtë vepër lënda e të cilës "e fshehur" në arkivat angleze, është përgatitur nga Bejtulla Destani, drejtues i Institutit të Studimeve Shqiptare në Londër dhe Auron Tare, drejtor i Parkut Kombëtar të Butrintit. Tare shpjegon iniciativën private të disa individëve me kontributin e studiuesit Destani në veçanti për t'iu paraqitur rrethve shkencore një vepër për të cilën nuk dihej thuajse asgjë dhe që ka dalë nga përkshimet e qindra kilometrave që Evans, zbuluesi i Knososit, ka bërë në Shqipëri dhe për vendet ku ai ka gërmuar si Shkodra apo Lezha.

Evans do të drejtonte Ashmolean Museum, një ndër më të njohurit e asaj kohe dhe qëndroi në këtë post deri më 1908. Gjatë punës në krye të këtij muzeu, në 1892 shkoi në Kretë. Aty i lindi mendimi se një zbulim interesant mund të ndodhte nëse ndërmerre gërmime arkeologjike dhe kështu filloi të kërkonte qytetin legjendar të mbretit Minos, Knosos. Evans bleu zonën e Kefalasit pranë Heraklios dhe më 23 mars 1900 filloi gërmimet e para arkeologjike. Vetëm pak javë do të duhej që ai të gjente gjurmët e një civilizimi që do ta bënte më vonë jo vetëm të famshëm, por edhe një prej njerëzve të cilët avancuan studimet evropiane dhe në veçanti të Mesdheut Lindor.

Ç'është kjo vepër e Arthur Evans?

Vepra *Research in Iliricum* (Kërkime në Iliri) botuar nga shtëpia botuese Angleze "Taurus" me autor një prej figurave më të rëndësishme botërore të arkeologjisë Sir Arthur Evans, është një surprizë interesante për të gjithë ata që janë të interesuar mbi çështjet ilirike dhe historinë antike të Shqipërisë.

Libri është përgatitur mbi dorëshkrimin origjinal të gjetur në arkivat angleze nga Bejtulla Destani. Do të thoshja se Destani është një nga personazhet e rrallë që unë kam takuar në fushën e studimeve shqiptare pasi i vetëm dhe pa asnjë ndihmë nga institucionet kulturore në Shqipëri apo Kosovë, ka mundur që të japë një kontribut të rëndësishëm në lëmin e studimeve dhe botimeve

shqiptare. Kontribut i cili besoj se vetëm ata që do të vijjnë pas nesh do ta kuptojnë seriozisht.

Mbi ç'dokumente është përgatitur Kërkime në Iliri?

Botimit *Kërkime në Iliri* nuk i është ndryshuar asgjë nga ato që studiuesi dhe arkeologu Evans kish përgatitur mbi kërkimet e tij në Shqipëri, Kosovë, Malin e Zi, Maqedoni dhe Kroaci: trojet e Ilirisë antike. Ky studim është kryer gjatë periudhës kur ai sapo kish mbaruar studimet në Universitetin e Oksfordit dhe udhëtonte nëpër Ballkan. Përveç interesit të tij si gazetar Evans kreu kërkime arkeologjike shumë të detajuara të cilat mund të ngrenë teza të reja për kohën në këtë fushë. Me shumë interes janë përfundimet e tij mbi popullsitë sllave dhe ardhjen e tyre në Ballkan dhe sigurisht për mbijetesën e popullsisë ilirike pas shembjes së perandorisë romake. Cili është kontributi i Evansit veçanërisht në fushën e ngushtë të studimeve ilirike?

Sir Arthur Evans është një prej emrave më të rëndësishëm në fushën e arkeologjisë dhe antropologjisë botërore. Studimet e tij për çështjen e civilizimeve parahelenike sollën një kuptim të ri dhe avancuan studimet evropiane dhe në veçanti të Mesdheut Lindor. Siç dihet, ai zbuloi Knososin e famshëm, qytetin legjendar të Mbretit Minos dhe zbuloi tabela balte me mbishkrime të famshme Linear A dhe Linear B.

Fakti që ky studiues i këtyre përmasave është marrë seriozisht me çështjet dhe studimet ilirike është domethënëse. Sigurisht koha kur Evans jetoi në Ballkan ishte një kohe kur po fermentohej çështja nacionale e një sërë kombesh të vegjël që ishin në Perandorinë Otomane. Prejardhja e këtyre kombeve ishte çështje e ditës si për kroatët dhe sllavët ashtu edhe për shqiptarët apo malazezët dhe ndoshta një prej arsyeve që e kanë shtyrë atë të merrej me këto studime ka qenë edhe njohja e prejardhjes së këtyre kombeve. Megjithatë do të thoshja se Evans është në pararojë të studimeve ilirike dhe një prej studiuesve më seriozë të epokës së tij. Nëse këto studime do të njiheshin më parë, me siguri që do të ishin bërë një pikë referimi për studiues të mëvonshëm.

Përse është përmendur pak apo në mos fare?

Figura e tij nuk njihet gjerësisht në Shqipëri apo Kosovë pasi deri tani nuk njihet fare kontributi i tij në studimet ilirike. Evans sigurisht që njihet nga një rreth i specializuar njerëzish për kërkimet dhe zbulimet në Knossos, por askush deri më sot nuk kish dëgjuar mbi kërkimet e tij për historinë ilire. Në fakt, disa arkeologë apo studiues të njohur shqiptarë kanë mbetur të befatur nga ky fakt i panjohur. Në studimin e tij ka mjaft mbishkrime të cilat tashmë janë zhdukur apo monumente të cilat "janë fshirë" me kalimin e kohës e që do t'i shërbejnë studiuesit të fushave të ndryshme.

Çfarë ruhet në dorëshkrim nga kjo punë kërkimore e studimore?

Dorëshkrimi i tij është përgatitur më 1881-83 dhe është bërë gati për botim, por për rrethana që nuk i njohim nuk është botuar. Pas kthimit në Angli, ai u emërua në drejtimin e Muzeut Ashmolean dhe, me sa duket, në këtë kohë ai ka punuar për këtë vëllim. Studimi i tij është një vepër e plotë, një punë voluminoze mbi kërkimet dhe gërmimet e tij në trojet ilire. Evans ka gërmuar mirëfilli në Shkodër, në kalanë e saj dhe në Lezhë. Me interes do të veçoja një kapitull të "Kërkimeve" ku ai merret me origjinën e disa princëve dhe fiseve ilirë, referencat që ai jep mbi familjet princërore epirote dhe atyre të Illiricumit të jugut si dhe prejardhjen e tyre.

Me një përpikmëri skrupuloze ka kopjuar me dorë dhjetëra mbishkrime të cilat tani kanë humbur. Ka përrshkuar në këmbë qindra kilometra në gjurmë të rrugëve romake si dhe ka vizituar një numër rrënojash antike. Interesant është koleksio-

ni i monedhave antike që ai ka mundur të gjejë apo të kopjojë gjatë periudhës së kërkimeve.

Me zbulimin e Knososit duket se Evans u përgendrua në këtë zbulim i cili solli informacione të reja mbi popullsitë e Mesdheut. Megjithatë, nga dokumentet e tjera që ne kemi në dorë duket qartë se ka vazhduar interesimi i tij për çështjet ilirike. Një numër i madh letrash dhe dokumentesh origjinalë, letërkëmbime me personalitete të kohës në Ballkan, përfshi këtu edhe figura nga Shqipëria do të përgatiten shumë shpejt në një botim të dytë mbi këtë figurë të madhe historike.

Si u bë i mundur botimi dhe kur mendohet të vijë i përkthyer shqip?

Me daljen nga botimi në fund të nëntorit është planifikuar që libri të prezantohet në Londër, Nju Jork dhe Paris, më vonë edhe në Tiranë e mundësisht edhe në Prishtinë. Këto do të bëhen në bashkëpunim me institucione ndërkombëtare që emri e fama e Arthur Evans të jetë një promovim i rëndësishëm për imazhin e Shqipërisë në rrethet shkencore evropiane. Madje një prej fondacioneve më të rëndësishme suedeze ka shprehur dëshirën ta prezantojë këtë libër në parlamentin suedez.

Vepra të tilla tërheqin vemendjen për çështje të trashëgimisë kulturore shqiptare. Megjithatë ky botim nuk ka ndihmën e asnjë institucioni shtetëror në Shqipëri, rëndësia e tij nuk i ka lënë disa shqiptarë indiferentë, por me kënaqësinë më të madhe kanë kontribuar për këtë botim. Këtu gjej rast të përmend Rudina Seserin, Igli Taren, shqiptaro-amerikanët Tush Nikollaj, Mark Berisha dhe Nancy Velu.

Apnea e natës rrit disa herë rrezikun e iktusit

Rreziku i iktusit është katër herë më i lartë tek personat e prekur nga apnea e natës. Ky është rezultati i një studimi të kryer nga Douglas Bradley në Toronto General Hospital dhe i publikuar tek revista *American Journal of Respiratory Critical Care Medicine*.

Studimi përfshiu 1475 persona, 22 prej të cilëve ishin prekur nga iktusi cerebral. Pesë prej tyre kishin pasur edhe episode të një apnee të rëndë gjatë natës me një rritje të rrezikut iktus katër herë më të lartë se të tjerët, pa lënë mënjanë faktorët e tjerë të rrezikut si diabeti,

hipertensioni dhe duhani.

Në një analizë të dytë të kryer mbi 1189 persona gjatë një periudhe prej 4-12 vjetësh studimi, Bradley arriti të vërtetojë rezultatet e mëparshme duke demonstruar se iktusi shfaqet pas episodeve të apneas së natës me një rrezik 3.5-4 herë më të lartë. "Fakti që iktusi ndjek apnean është një element i fortë që sugjeron një lidhje shkak-pasojë midis dy ngjarjeve", përfundon studiuesi Bradley

American Journal of Respiratory Critical Care Medicine

135 DOCTORAL GRANTS AT THE EUROPEAN UNIVERSITY INSTITUTE IN FLORENCE

The EUI is one of Europe's leading academic institutions in postgraduate studies. The Institute is unique in its European, comparative and interdisciplinary focus, and offers up to four years scholarship to research students, leading to a doctorate.

Applications are invited for the doctoral programmes in:

- Economics
- History & Civilization
- Law (also one-year LL.M. programme)
- Political & Social Sciences

Further information and online application materials are available at <http://www.iue.it/Servac/Postgraduate/>. For queries please contact applyres@iue.it.

Application and Admission

All applications are to be submitted using the EUI online application form. Hard copies of the application are no longer required.

The annual application deadline is 31 JANUARY 2006.

To apply to the postgraduate programme offered by the Institute, go to the admission pages (links also to be found in the menu on the left). On these pages, information can be found on admission conditions, scholarship details, frequently asked questions, how to apply and the selection process.

Here you can also find information on what life is like in Florence, and the resources that the Institute makes available to researchers in regard to:

- visas and permits
- health care issues
- finding accommodation
- daycare facilities
(Crèche and schools)

AGRON ALIBALI

RESEARCH FELLOWSHIPS AVAILABLE: AMERICAN COUNCILS SOUTHEAST EUROPE RESEARCH PROGRAM

Fellowship Date: 2006-01-15

Date Submitted: 2005-12-05

Announcement ID: 148875

The American Councils Southeast Europe Research program provides full support for graduate students, faculty, and post-doctoral scholars seeking to conduct research for three to nine months in Albania, Bosnia-Herzegovina, Bulgaria, Croatia, Macedonia, Romania, and Serbia and Montenegro. Scholars may apply for support for research in more than one country during a single trip, provided they intend to work in the field for a total of three to nine months. Full and partial fellowships are available for research and/or language training through American Councils from the U.S. Department of State (Title VIII) grant support.

Scholars in the humanities and social sciences are eligible to apply for the program. While a wide-range of topics receive support each year, all funded research must contribute to a body of knowledge enabling the U.S. to better understand the region and formulate effective policies within it.

All applicants should clearly describe the policy-relevance of their work, be it in anthropology, literature, history, international relations, political science, or some other field.

Outbound Programs/Title VIII Research Scholars

American Councils for International Education: ACTR/ACCELS

1776 Massachusetts Avenue, NW, Suite 700
Washington, DC 20036

Telephone: (202) 833-7522

Email: outbound@americancouncils.org

Visit the website at <http://www.americancouncils.org>

LEA YPI

CALL FOR PAPERS: «ARCHAEOLOGY, ANTHROPOLOGY AND HERITAGE IN THE BALKANS AND ANATOLIA: THE LIFE AND WORKS OF F.W. HASLACK, 1878-1920». SECOND INTERNATIONAL CONFERENCE. UNIVERSITY OF WALES GREGYNOG.

6th-9th May 2006.

<http://www.ejts.org/document331.html>

The first 'Hasluck' conference took the life and works of F.W. Hasluck as the starting point for a wide-ranging exploration of the peoples and cultures of south-east Europe looking at such issues as the place of the remains of the past in the present, the ethnography of the region, nationalism and heritage, western excavation, the schools and institutes abroad, the careers and personalities associated with research in the area, cultural continuities, and conversion and shared religious monuments. Since that conference, there have been number of enquiries as to when the next event may be held. Emboldened by this, the organisers have resolved to hold a second such event, which will aim to build upon the first and provide at the same time a further body of published material to complement the first's proceedings.

The location for the second conference will be once more the University of Wales Gregynog, a beautiful converted country house in the heart of the Welsh countryside. The conference committee consists likewise of Mr Keith Hopwood (University of Wales Lampeter), Professor Stephen Mitchell (University of Exeter), and Dr David Shankland (University of Bristol).

In general, the areas covered by the conference remain that same: that is 'personalities'; 'the schools abroad'; 'ethnography and the Alevi-Bektashis'; 'syncretism and conversion'; 'travellers, empire and nation'; and 'archaeology, heritage and ideology'. The Committee do not wish to anticipate the papers that may be offered, but it is hoped more specifically that there may be panels as outlined below. In terms of content, new archival or field research is welcome, as is wider synthesis:

A) The Life and Work of F. W. Hasluck, and of his wife, Mrs M. Hasluck, including figures active or influential in their circle: for instance Anderson, Bosanquet, Finlay, Halliday, Harrison, Hogarth, Myres, Penrose, Tod, Woodward.

B) The Schools and Institutes abroad: for instance, the Russian Institute in Istanbul, the British School at Athens, the German Archaeological Service abroad (particularly but not only in Athens and Istanbul), the Foreign Schools in their wider Mediterranean context, and so on.

C) Ramsay and Epigraphic Research in Anatolia: the work, theories and life of Ramsay, including consideration of his successors and predecessors, such as Hamilton.

D) Archaeology and Archaeologists in the Ottoman Empire, whether 'official', (such as Hamdi Bey); 'free-lance' (such as Van Lennup), or from the West (such as Newton).

E) The ethnography of the region in general, but especially the heterodox groups such the Alevi, Bektashis, Yezidis, or Pomaks, their geographical distribution and their present circumstances.

F) Heritage and the creation of culture in diverse regional contexts: that is, the relationship between nationalism, archaeology and heritage, and whether systematic patterns or local divergences may be observed in this complex relationship across the region.

G) Cultural continuities, including, as well as continuities, issues surrounding culture, conflict and conversion, and the way that social breakdown may impact upon hitherto shared aspects of culture, such as shrines or religious monuments.

H) Ethnographic researches particularly into contemporary understandings of the remains of the past in the region, and possible distinctions that may be made between individual and collective memory.

I) The establishment of modern disciplinary boundaries, such as the reform of the Cambridge Tripos in the late XIX century, or the emergence of social anthropology, its split from archaeology, and implications for our research.

In the first instance, those who would like to take part are invited to forward a proposed title and abstract of 150 words, along with their name and contact address, to DShankland@yahoo.co.uk and D.P.Shankland@Bristol.ac.uk. Any member of the Committee would also naturally be delighted to answer informal enquiries.

1 nëntor 1983 – Piratët e rrjetit Kompjuterët e mbarë botës nga kjo datë janë më pak të sigurtë. Një student në sigurinë informatike në Universitetin e Kalifornisë, Fred Cohen, realizon virusin e parë informatik. I pari që u dënua nga një gjykatë për shpërndarjen e një virusi të tillë ishte amerikani Christopher Pile që u arrestua më 1995. Sipas vlerësimit të ndërmarrjes (shtëpia prodhuese e produkteve Norton Antivirus) llojet e viruseve informatikë të individualizuar deri në shtator 2002 ka qenë mbi 60.000 por kjo shifër rritet çdo ditë në mënyrë drastike.

4 nëntor 1972 – Lamtumirë rreze X Këtë ditë në një spital të Londrës u krye ekzaminimi i një pacienti me anë të sistemit të Tomografisë Aksiale të Kompjuterizuar (TAC), një metodë diagnostikimi që bazohet në përpunimin në kompjuter të një sërë radiografish të thella për pjesë të ndryshme të trupit. Me këtë procedurë mund të merren imazhe me cilësi tepër të lartë. Teknika që kompletonte Tac-un është Rezonanca Manjetike Nukleare (RMN) që bën të mundur një analizë më të thellë pa e ekspozuar organizmin ndaj radiacionit.

6 nëntor 1780 – Bretkosa e elektrizuar Mbrëmjen e 6 nëntorit 1780 anatomisti italian Luigi Galvani duke kryer një eksperiment preku pa dashur me një hark përcjellës muskujt e këmbës së një bretkose të ngordhur dhe shih se kafsha lëviz me një kërcim. Galvani është i bindur se ka zbuluar një "rrymë elektrike" misterioze të prodhuar nga truri e të transferuar tek muskujt e kafshës. Në të vërtetë, pa e ditur, ai shpiku prototipin e pilës elektrike: harku bimetalik gjeneron një diferencë potencialesh që merret nga kontraktimi i muskujve të bretkosës.

7 nëntor 1633 – Galera nën det Një prodhues qelqi holandez me pasionin për lundrimin ndërtoi më 1620 nëndetsen e parë primitive e cila arriti të zhytet deri 4 metra në ujrat e Tamizit. Pjestarët e ekuipazhit merrnin frymë me anë tubash që dilnin deri në sipërfaqe por koha e zhytjes nuk mund të ishte më tepër se tre orë. Kjo nëndetëse në formë dhe funksionim nuk ishte shumë ndryshe nga një galerë, anija luftarake mesjetare e shtyrë nga vozitës të fuqishëm pjesa më e madhe e të cilëve skllevër apo të burgosur.

10 nëntor 1885 – Motoçikleta anti-ke Eshtë viti 1885 kur motoçikleta e parë në histori e ndërtuar nga Gottlieb Daimler (shpikësi i motorit me shpërthim) debutoi. Ajo kish dy rrota dhe ish krejtësisht prej druri (edhe rrotat). Ushqehet nga një motor me benzinë dhe kish një shpejtësi prej 12 km/h. Gara e parë motoçiklistike u zhvillua në Paris më 1887 por në të u paraqit vetëm një konkurent me një motoçikletë të prodhuar me duart e tij e cila arrinte deri 25 km/h duke vendosur kështu rekordin e shpejtësisë për atë epokë.

13 nëntor 1946 – Inseminimi i shiut Fizikani dhe meteorologu amerikan Vincent Schaefer fluturoi me një aeroplan në qiellin e Massachusetts, hyn në një re dhe mbjell "akull të thatë" (grimca anhidridi karbonik në gjendje të ngurtë). Në qytetën amerikane bie kështu shiu i parë artificial i historisë. Kjo bëhet e mundur sepse me anhidridin karbonik avulli i ujit kondensohet duke formuar kështu pikat e shiut. Kjo metodë përdoret prej dyzet vjetësh në Izrael ku arrijnë të krijojnë një sasi shiu artificial më të madhe se ai në kushte natyrale.

14 nëntor 1908 – Fletët e ambalazhimit Kimisti svicerian Jacques Edwin Brandenberger krijon celofanin që bëhet menjëherë një nga materialet më të përdorur për ambalazhimin. Produkti i parë i mbështjellë me këtë material ishte një paketë çamçakëzi e trëhtuar në Shtetet e Bashkuara më 1931. Alumini u fut për herë të parë në shtëpitë e konsumatorëve më 1947 si material tjetër për ambalazhimin e ushqimeve. Ai është i lehtë dhe jo helmues, me trashësi gjashtë të mijtat e milimetrit (një e pesta e trashësisë së letrës normale).

15 nëntor 1630 – Astronom i lindur Vdes në Regensburg një nga astronomët më të mëdhenj të të gjitha kohërave, Johann Kepler. Ai e kaloi rininë e shtyrë nga familja për një jetë ekleziale meqë ishte dobët e nuk mund të kryente punë fizike. Shpejt Kepleri u apasionua pas teorisë heliocentrike të Kopernikut gjë që e detyroi të largohet nga Universiteti i Tubingenit për tu strehuar në Pragë ku u bë matematicieni i perandorit. Në bazë të studimeve të tij revolucionare u themelua fizika kuantike dhe ai shpjegoi për herë të parë se si lëvizin planetët në bazë ligjesh matematike e fizike.

16 nëntor 1996 – Lazeri atomik Në laboratorët e MIT-it (Massachusetts Institute of Technology) në Boston u realizua lazeri i parë atomik. Ai lëshon drejtpërdrejt atome koherente që mund të përdoren sikur të ishte një rreze drite. Lazerët tradicionalë, përkundrazi, lëshojnë një rreze drite koherente të përbërë nga fotone në të njëjtën gjendje kuantike. Lazeri i ri filloi të përdoret kryesisht në fushën e fizikës për matjet me saktësi, dhe në mikroelektronikë për të realizuar qarqet e integruar me gjurmë të përmasave të barabarta me një atom të vetëm.

17 nëntor 1970 – Një mi i vogël Patentohet mausi i parë i historisë i lindur gjatë viteve '60 nga gjeniu Douglas Engelbart, një nga studiuesit më të mëdhenj për marrdhëniet njeri-kompjuter. Ky maus i parë ishte një bllok druri me një pulsant të kuq. Për të dalë nga laboratorët në raftet e dyqaneve atij iu deshën plot 11 vjet kur Xerox nxjerr kompjuterin e parë me një ekran grafik dhe një maus. Vitin që vijon, 1982, grupi i mirënjohur Apple e përmirëson dukshëm funksionimin e mausit dhe e nxjerr në treg me kompjuterin e tij të parë të quajtur Lisa.

19 nëntor 1998 – Lamtumirë zoti Tornado Vdes Tetsuya Fujita, i njohur si Mr. Tornado. Fizikani japonez përpunoi një shkallë për të matur intensitetin e tornadove e cila mori emrin e tij. Në shkallën Fujita, e cila bazohet në raportin shpejtësi e erës-dëme të shkaktuara shkohet nga F-0, me erëra deri në 100 km/h dhe thyerje degësh, deri në F-5: erëra 500 km/h dhe shtëpi të rrëmbyera me vete. Vorbulla e tornados mesatarisht ka një gjerësi prej 300 metrash dhe lëviz në vijë të drejtë për rreth 30 kilometra.

22 nëntor 1927 – Slita me motor Patentohet slita e parë me motor. Carl Eliason pas dy vjet pune në depon e dyqanit të tij ushqimor në Wisconsin përfundon "tobogën e motorizuar". Prototipi ishte një slitë me dy ski të gjata për të rrëshkitur në dëborë me një motor me dy kuaj e gjysëm fuqi dhe një radiator veture. Eliason ndërtoi 40 të tjerë por nuk arriti të shesë shumë. Pak vjet më vonë ai ndërtoi një slitë më të madhe e me motor më të fuqishëm që arrinte një shpejtësi prej 64 kilometrash në orë.

24 nëntor 1859 – Seleksioni natyror Del në Londër libri i Çarl Darvinit *Origjina e species* dhe menjëherë është një sukses. Tirazhi prej 1250 kopjesh, një shifër e konsiderueshme për epokën, shitet brenda ditës. Teoritë e Darvinit shkatuan polemikën të fuqishme që u luftuan me ashpërsi por patën edhe mbështetje të gjerë të cilat u shtuan gjatnjë e më tepër kur zbulimet në fushën e biologjisë i vërtetuan këto teori.

27 nëntor 1880 – Harku i madh Lindi në Angli Ralph Freeman, ndërtuesi i njerës prej veprave më të njohura në botë të inxhenerisë civile: Sydney Harbour Bridge. Veçantia e kësaj ure qëndron tek struktura asimetrike e pilastrove që e mbajnë të cilët ndodhen njeri nga një anë e tjetri në anën tjetër. Ura është e gjatë rreth një kilometër dhe përshton gjirin e Sidneit 65 metra mbi nivelin e ujit.

30 nëntor 1814 – Shtypi me avull Del kopja e parë e një gazete, *Times* e Londrës, i realizuar me një makinë tipografike me avull. Kjo makinë e re lejonte të shtypeshin shumë më tepër kopje me një vëllim faqesh më të madh se më parë: *Times* kaloi nga një tirazh prej 300 kopjesh në ditë në 1100 kopje në orë. Sot një nga të përditshmet me tirazh më të madh në botë është *New York Times* që në numrin e së dielës arrin ditë me mbi një milionë e gjysëm kopje.